



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 144

VENDIM

**PËR REGJISTRIMIN E Z. KRESHNIK LUAN MERXHANI SI KANDIDAT PËR DEPUTET I
PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT, NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU GJIROKASTËR,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga komiteti nismëtar për regjistrimin e z. Kreshnik Luan Merxhani si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 63, datë 11.02.2021 ka regjistruar komitetin nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e z. Kreshnik Luan Merxhani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Me shkresën nr. 1783 prot., datë 08.03.2021, komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet mbështetëse të 1 289 zgjedhësve, për të cilët shprehet se janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.



Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Qarku Gjirokastrë; Model – 04;
2. Deklaratë e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkuron në zgjedhje, Model - 05;
3. Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, të nënshkruar prej tyre Model - 06;
4. Jetëshkrimi i kandidatit Model – 07;
5. Formulari i vetëdeklarimi.

Në mbështetje të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7 të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi komitetin nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Neni 69 pika 3 përcakton se Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3000 (tre mijë) zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se Qarku Gjirokastrë ka 123 341 (njëqind e njëzet e tre mijë e treqind e dyzet e një) zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 69, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1 për qind të listës së 123 341 zgjedhësve të zonës zgjedhore Gjirokastrë është 1 233 (një mijë e dyqind e tridhjetë e tre) zgjedhës.

Administrata e KQZ-së verifikoi nënshkrimet e zgjedhësve në listat mbështetëse për Qarkun Gjirokastrë për të cilat rezultoi se gjithsej janë dorëzuar në total 1 289 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) nënshkrime të plotësuara sipas modelit 06. Për çdo zgjedhës në listë bashkëlidhur është depozituar dhe kopje e letërnjoftimit e nënshkruar prej tyre.

Në bazë të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nga administrata e KQZ-së është bërë verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 65 (gjashtëdhjetë e pesë).



Në përfundim, nga verifikimi i nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit mbështetës rezulton se numri i zgjedhësve që kanë nënshkruar në listën mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta është më i madh se numri minimal i kërkuar në bazë të nenit 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor, për nënshkrimet.

Referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat për deputet.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kandidati për deputet i propozuar nga zgjedhësit, z. Kreshnik Luan Merxhani ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 020, datë 08.03.2021, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Kreshnik Luan Merxhani, Qarku Gjirokastrë, rezulton se, në rubrikën III, “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”,,

- PIKA 4 ”A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale?”, është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se është ndaluar/arrestuar nga Komisariati nr. 1 Tiranë, për kundërvajtje administrative, më datë 24.03.2020, vepër për të cilën është shfuqizuar me akt normative nr. 16 datë 17.04.2020.
- PIKA 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se, ka jetuar në Ishullin Sifinos, për arsye familjare, për periudhën gusht 1996 deri më tetor 1997.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 1891prot., datë 10.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1890 prot., datë 10.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet të propozuar nga zgjedhësit në Kuvendin e Shqipërisë, z. Kreshnik Luan Merxhani, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.



Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 2591/1 prot., datë 11.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Kreshnik Luan Merxhani i cili rezultoi se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, pra nuk është i dënuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet z. Kreshnik Luan Merxhani.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Kreshnik Luan Merxhani, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 69, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të regjistroj z. Kreshnik Luan Merxhani, si kandidat për deputet të propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

